



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 662 , datë 23.10.2024

P Ë R

**KRIJIMIN E REGJISTRIT PËR KTHIMIN E GARANCIVE
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr.55/2023, "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera", dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e regjistrit për kthimin e garancive shtetërore për mbajtjen, arkivimin dhe përditësimin e të dhënave të garancive e mbledhjen e të gjithë dokumentacionit dhe raportimeve të huadhënësve.
2. Regjistri për kthimin e garancive shtetërore, si bazë të dhënash, funksionon, administrohet dhe ndërvepron me bazat e tjera të të dhënave,

në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

II. PËRMBAJTJA E REGJISTRIT

1. Të dhënat që përmban regjistri për kthimin e garancive shtetërore ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore për menaxhimin e garancive shtetërore do të konsiderohen:

- i. kodi i identifikimit;
- ii. produkti;
- iii. përshkrim-veprimi;
- iv. data e pagesës;
- v. shuma e disbursuar;
- vi. statusi i këstit të principalit;
- vii. data e shlyerjes së pagesës;
- viii. principal;
- ix. përqindja e mbulimit të principalit;
- x. interesi dhe masa e mbulimit të interesit nga garancia;
- xi. stoku;
- xii. dokumentacioni në formë PDF-je;
- xiii. të dhëna lidhur me pasuritë e lëna si kolateral apo të sekuestruara;
- xiv. kthimet e garancisë nga huamarrësit.

b) Të dhëna dytësore për menaxhimin e garancive shtetërore do të konsiderohen:

- i. të dhënat për subjektin/personin fizik ose juridik;
- ii. NIPT-i;
- iii. të dhënat për gjenealogjet e individit (për personat fizikë, dorëzanësit apo administratorët e subjektit);
- iv. numrin personal i identifikimit (ID) të subjektit apo të personit fizik;
- v. të dhënat e regjistrit tregtar për datën e regjistrimit të subjektit, emrin e subjektit/shoqërisë tregtare, numrin unik të identifikimit të subjektit, llojin e shoqërisë tregtare (formën e organizimit të saj);
- vi. të dhënat e identifikimit të themeluesve;
- vii. të dhënat për selinë/vendndodhjen e biznesit apo për administratorit;

- ix. të dhënat lidhur me pasuritë shtetërore dhe të paluajtshme;
x. të dhënat mbi statusin e kredisë në bankat e nivelit të dytë;
x. të dhënat për statusin e pagesës së sigurimeve shoqërore.

III. NDËRLIDHJA ME BAZËN E TË DHËNAVE

1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (në vijim AMGKP) përcakton ndërveprimin e regjistrin për kthimin e garancive shtetërore me baza të tjera të dhënash shtetërore.
2. AMGKP-ja, për regjistrin për kthimin e garancive shtetërore, ndërvepron duke shkëmbyer të dhëna me databazat e regjistrave, si më poshtë vijon:
 - a) Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, e cila merr informacion për kredimarrësin për numrin e pasurisë, zonën kadastrale, volumin, faqen, adresën e pasurive;
 - b) Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila merr informacion për kredimarrësin nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC), i vitit 2010, për të dhënat e vendbanimit, përbërjen familjare dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve;
 - c) Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila merr informacion lidhur me statusin e aktivitetit (aktiv, pasiv), ekstraktin historik të kredimarrësve;
 - d) Bankën e Shqipërisë, e cila merr informacion nga bankat e nivelit të dytë, nëse kredimarrësi është debitor i keq;
 - dh) Institutin e Sigurimeve Shoqërore, i cili merr informacion lidhur me pagesat e sigurimeve të punonjësve, që kanë në ngarkim kredimarrësit;
 - ë) Regjistrin e barrëve siguruese;
 - e) Regjistrin e pronarëve përfitues;
 - f) Regjistrin e llogarive bankare (regjistri qendror i llogarive bankare dhe i kasetave të sigurisë, si një bazë e të dhënave shtetërore, në të cilin regjistrohen e ruhen të dhënat, sipas përcaktimeve të ligjit nr.154/2020, "Për regjistrin qendror të llogarive bankare", të ndryshuar, në formë elektronike).
3. Të gjitha të dhënat e administruara nga regjistri dhe dokumentacioni, që administrohet në sistem, ruhen të plota nga institucionet financiare për 10 (dhjetë) vjet nga mbyllja e llogarisë bankare ose e kasetës së sigurisë. Përpunimi i të dhënave personale dhe informimi i subjektit të të dhënave personale nga ana e institucioneve financiare kryhet sipas rregullave të

parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të dhënat e mbajtura në regjistrë përmbajnë sekret bankar e profesional dhe duhen trajtuar dhe duhen ruajtur si të tilla nga të gjitha autoritetet që kanë akses në to.
5. Të dhënat e mbledhura nga regjistri do të përdoren për:
 - a) mbledhjen e borxhit;
 - b) menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas;
 - c) kthimin e garancive shtetërore të huas;
 - ç) kthimin e huave dhe nënhuave të dhëna nga ministri përgjegjës për financat;
 - d) verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse, për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, të huave dhe nënhuave, të dhëna nga ministri përgjegjës për financat;
 - dh) përpunimin e analizave statistikore;
 - e) identifikimin dhe raportimin në kohë reale të të dhënave lidhur me kredimarrësit apo nevoja të ndryshme të procesit të punës.
6. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë është administrator i informacionit dhe përgjegjës për përditësimin e regjistrit.

IV. NIVELET E AKSESIMIT

1. Aksesimi në regjistrë është i përcaktuar, si më poshtë vijon:
 - a) Lexues;
 - b) Përpunues të dhënash;
 - c) Administrator.
2. Lexues është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e skemave të veçanta të garancisë dhe struktura përgjegjëse e verifikimit të kërkesave të garancisë dhe konfirmimit të kontratave.
3. Përpunuesi i të dhënave është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e skemave të veçanta të garancisë dhe struktura përgjegjëse e verifikimit të kërkesave të garancisë dhe konfirmimit të kontratave, të cilat kanë dy nivele aksesimi për përpunim:

a) Përpunuesi i të dhënave me përmbajtje ekonomike është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e skemave të veçanta të garancisë dhe përpunon të dhënat lidhur me:

- i. shtimin e kredive të reja;
- ii. përpunimin e kodit të identifikimit, emrin e subjektit apo personit fizik;
- iii. produktin;
- iv. përshkrimin e veprimit;
- v. datën e pagesës;
- vi. shumën e disbursuar;
- vii. statusin e këstit të principalit;
- viii. datën e shlyerjes së pagesës;
- ix. principalin;
- x. përqindjen e mbulimit të principalit;
- xi. interesin dhe masën e mbulimit të interesit nga garancia;
- xii. stokun e detyrimit ndaj huadhënësit dhe stokun e detyrimit ndaj Ministrisë së Financave;
- xiii. skedulin e amortizimit.

b) Përpunuesi i të dhënave me përmbajtje juridike është struktura përgjegjëse e verifikimit të kërkesave të garancisë dhe konfirmimit të kontratave dhe përpunon e ngarkon në sistem të gjithë dokumentacionin juridik të raportit kredidhënës-kredimarrës, si:

- i. marrëveshjet e bankave me ministrinë përgjegjëse për financat;
- ii. kontratat e bankave me secilin prej kredimarrësve;
- iii. marrëveshjet e mirëkuptimit me bankat dhe kredimarrësit;
- iv. shkresat e ardhura nga banka në AMGKP lidhur me subjektin për thirrje garancie apo plotësim të dhënash;
- v. shkresa të bëra nga AMGKP-ja drejt bankave për kërkesë informacioni;
- vi. shkresa të bëra nga AMGKP-ja drejt kredimarrësve për detyrimin që kanë ndaj ministrisë përgjegjëse për financat;
- vii. shkresat e raportimit mujor, të ardhura nga bankat në AMGKP dhe çdo shkresë apo dokument tjetër juridik, që lidhet me subjektin e veprimtarisë.

4. Administrator teknik i regjistrit është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ndërkohë pronar me të drejta dhe përgjegjësi të plota për të dhënat që ruhen, administrohen dhe përpunohen në regjister është Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

VASILIKA VJERO

NR.PROT. 5566/2
DATË 23.10.2024

MINISTRISË SË FINANCAVE
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE
KREDIVE TË PAKTHYERA
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

